

KOSOVARJA

Ballina: Granit Xhaka





Pse armiqtë
tanë
i frikëson
plisi ynë

UB takohet
me afaristë
nga Kosova

Vajzat
i falë Zoti
e i merr
dreqi

Pse gruaja
nuk ma do
nënë

*Shqiptari
i madh*
**GRANIT
XHAKA**



JEWELS
BLACK GOLD JW 11



DIMENSIONI

150 x 600

600 x 600

1200 x 2780 x 6

Në ballinë:
Granit Xhaka

*Shqiptari
i madh*
**GRANIT
XHAKA**

Kush nuk e njeh Granit Xhakën?! I madh e i vogël e njohin. Sepse, Graniti është idol i papërsëritshëm i futbollit.



Familja e Granit dhe Taulant Xhakës u zhvendosën nga Podujeva në Zvicër në kohën kur djemtë e tyre ende nuk ishin lindur.

Prindërit e Xhakës e dinin se kishin nevojë për një fillim të ri dhe në vitin 1990 emigruan në Zvicër. Djali i tyre i parë, Taulanti, u lind në Basel, në vitin 1991, kurse Graniti u lind po në të njëjtin qytet 18 muaj më vonë. Taulanti është vëllai i madh i Granitit, i cili, gjithashtu, është futbollist profesionist, e që na ka bërë tejet krenarë me lojën e tij me fanellën kuqezi. E, ta kuptosh historinë e hershme të jetës së Granit Xhakës, do të thotë ta kuptosh familjen e tij, sa kanë vuajtur dhe sa janë sfiduar ndër vite...

KË E KA IDOL GRANIT XHAKA?

Për familjen e tij, në një rast, Graniti është shprehur: "Babai tregoi një forcë të pabesueshme dhe unë e Taulanti jemi rritur me forcën e tij mendore. Babanë e kemi idhull, model, i cili na mësoi se duhet të jemi të fortë për të arritur atë që synojmë në jetë. Kështu, pra, me kohë vëllai dhe unë u bëmë shumë të fortë. Kjo edhe është arsyeja pse në fushën e futbollit e kemi këtë forcë mendore, për t'i marrë

përsipër me të vërtetë gjërat se si rrjedhin...".

KUSH ISHTE BABAI I VËLLEZËRVE XHAKAJ?

Babai i Taulant dhe Granit Xhakës, Ragip Xhaka, është nga Podujeva, krenar që dikur protestoi ndaj sundimit të atëhershëm të Jugosllavisë Komuniste në Kosovë. Ai u ngrit për të drejtat kombëtare.

Por, u arrestua nga qeveria e kohës. E, para tij ishte arrestuar edhe xhaxhai i tij, i cili qe dënuar me 15 vjet burg, kurse Ragipi u dënua me 3 vjet e gjysmë burg.

Një nga detajet më zbuluese në lidhje me nënën e Xhakës, Elmaze Xhakën,

është se ajo u takua me burrin e saj vetëm tre muaj para arrestimit dhe burgosjes së tij.

Xhaka, me një rast, thotë: "Kam një respekt të jashtëzakonshëm për nënën time. Nuk kam dëgjuar kurrë që një grua të jetë së bashku me një burrë vetëm tre muaj - në atë moshë të re - dhe, pastaj, ta presë atë tre vjet e gjysmë! Nëna ime është, thjesht, një person i pabesueshëm".

Andaj, Granit Xhaka, nga e kaluara, ka shumë kujtime dhe pasioni e dëshira për futbollin shpeshherë e kanë çuar në përfundime të ndryshme, e që janë diskutuar mjaft.

Menaxherët në "Arsenal" shpesh janë ndërruar, por Xhaka, pa dyshim, ka mbetur njëri nga lojtarët me vazh-



dueshmërinë më të madhe në skuadër.

Sidoqoftë, shqiptari i artë i fushës së blertë, së fundi ka qenë në qendër të vëmendjes së opinionit shkaku i ndeshjes Zvicër-Serbi, ku ai edhe një herë tregoi se di të bëjë lojë të mirë në fushën e futbollit dhe kënaqi zemrat e shqiptarëve dhe të adhuruesve të tjerë kudo që janë.

PSE PROVOKOHET VAZHDIMISHT GRANIT XHAKA?

Në fitoren jashtëzakonisht të rëndësishme (3:2) të Zvicrës ndaj Serbisë, mesfushori nga Kosova, Granit Xhaka, ishte cak i provokimeve të vazhdueshme, për çka 30-vjeçari reagoi në fushë me një gjest që nuk kaloi pa u komentuar...

Dhe, pas asaj ndeshje në Katar, në kuadër të "Kupës së Botës", Xhaka u shprehë:

"Ata që përqendrohen më mirë janë relativisht imun ndaj turbulencave emocionale".

EPITETET E GRANIT XHAKËS...

Granit Xhaka është futbollist i jashtëzakonshëm, i cili luan si mesfushor për klubin anglez "Arsenal" në Premier League dhe për Kombëtaren Zvicerane.


Pra, është lojtar i rregullt i Zvicrës që nga viti 2011, e që ka pasur suksese të lakmueshme në skuadër pothuajse në të gjitha ndeshjet. Trajneri i Kombëtares Zvicerane, Otmar Hitzfeld, e përshkruan Xhakën si "Schweinsteigeri i ri".

Por, shkaku i zgjuarsisë dhe dashurisë që ka për shkencën, Xhaka nga shokët e tij e ka epitetin "Albert Ajnshtani i ri".

JETA E FAMILJARE E XHAKËS

Xhaka, krahas lojës në fushën e futbollit, nuk është person që e ka mbajtur të izoluar jetën e tij private. Në vitin 2017 Xhaka është martuar me Leonita Lekajn, me të cilën kanë dy vajza.

N. Neziri



Granit

Xhaka

Taulant

Xhaka



QYSH ME DAL PREJ BUNARIT?



Kësaj radhe nuk u mundova të shkruaj shkrim timin autorial. Jo se nuk ka çka të shkruhet, as se nuk pata çka e për çka të shkruaj, nga kjo përditshmëri jona, e cila përditë e më shumë po habitemi me gjërat që po ecën, ndodhin, po i përjetojmë vetë...

Nejse...

Në këtë fundvit e pashë më të arsyeshme t'i transmetoj pak fjalë nga tradita jonë, nga përvoja jonë, nga jeta jonë, e që kanë mbetur në mendjen e disa pleqve që kanë mbetur sot gjallë. Janë fjalë të cilat flasin shumë, aq më shumë japin mesazh.

Një plak, para se të vdiste, i afroi djemtë dhe u tha nga përvoja e vet: Në jetë njeriu duhet t'i mbajë me vete gjithmonë tri gjëra: Një metër, një guri dhe një gjilpërë.

E, pse këto? – e pyetën djemtë. – Pse ta mbajë metrin me vete?

Plaku u përgjigj: Ta mat vendin ku do të ulet në mesin e të tjerëve.

E gurin, pse?

Ta peshojë fjalën e vet para se të flasë. Po gjilpërën?

Ta thumbojë veten para se t'i thumbojë të tjerët... – u gjegj plak.

*

Nji zot shpije, i nji familjeje të madhe, qohet e shkon te hoxha.

“Kam ardh me ma shkruie nji hajmali”, i thotë hoxhës.

“Hajrli koftë, o burrë! Po, për kë ashtu?”

“Për robtë e shpisë teme”.

“Pse, çka kanë?”; e pyet hoxha.

“Janë tranue valla, s’di çka me ba me ta!”.

“Sa rob jeni?”; e pyeti hoxha.

“Me mue tridhjetë e shtatë”, i gjegjet burri.

“Ani mirë”, i thotë hoxha dhe ia shkruan hajmalinë. “Këtë hajmali veç ti baje dhe kurrkush mos ta sheh!”, i thotë hoxha.

“Jo, bre hoxhë, unë se kam për veti, por për robtë e shpisë, për familjen”, ia kthen burri pak i revoltuar.

“Jo, burrë, ti mbaje se katërdhet rob të trent e i zoti i shpisë me kanë me mend, kjo nuk ban vaki hiq!”.

*

Kishte pas ra njani në bunar. Kojshia e kishin pa dhe kishin shkue me i ndihmue për me nxjerrë.

“Qysh ke ra poshtë, o kojshi?!”, e pyesnin derisa mundoheshin me e nxjerrë.

“Mos m’vetni qysh kam ra, por qysh me dal prej bunarit!”.

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Rilinda Krasniqi

Ardita Dili

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com

Pse armiqtë tanë i frikëson plisi ynë?

Punuesit e plisave e ruajnë thënien “Plisi i bardhë është për ta mbuluar zinë kombëtare, për një të ardhme më të ndritshme!”.

Plisi ynë, sa më shumë që është ndaluar nga pushtetarët e huaj, aq më shumë është bartur! Këtë e dëshmon edhe Sahit Mula, në familjen e të cilit trashëgohet historikisht lidhja me patriotët kombëtarë, ndër ta edhe lidhja me Bajram Currin. Kjo familje që një shekull e ka artizanat familjar punimin e plisit.

“Plisi, si një simbol kombëtar, është një zanat jo i lehtë”, thotë Sahit Mula në kohën kur e zhvilluam këtë bisedë, njeriu i cili e ka udhëhequr ekonominë e shumë ndërmarrjeve në Gjakovë, nga ato të karakterit shtetformues deri te postet më të larta në ndërmarrjet me renome kosovare dhe slllovene, por nuk ka hequr dorë nga punimi i plisit, me qëllim që ta ruajë traditën familjare.

SAHIT MULA IA VURI NË KOKË PLISIN IBRAHIM RUGOVËS

Mula ia ka vënë plisin në kokë Ibrahim Rugovës, teksa i përcillte punimet e Kryesisë së Degës së LDK-së në Gjakovë.

Sipas tij, plisi është një kompleks

strukturor i veçantë përpunimi, si i tillë, nuk është vetëm një “harrën” i bardhë.

Për rëndësinë e plisit, Sahit Mula, në shtëpinë e tij, në vitin 2008 kur edhe e zhvilluam këtë bisedë, flet si profesionist dhe i tregon anët e dobishme të plisit në raport me mbrojtjen e kokës, përveç anës kombëtare që armiqtë kanë pasur frikë prej tij.

SI BËHET PLISI?

Sahit Mula e ka përshkruar procesin e bërjes së një plisi, për të cilin proces thotë:

“Për ta punuar një plis duhet të kalo-het nëpër 16 hapa, ose procese, që duhet pasur fuqi punëtore të mirë. Procesi, natyrisht, merr kohë dhe material kualitativ. Lënda e parë e plisit është leshi.

E kam filluar këtë zanat qysh në vitin 1967, kur babai im, Jusufi, u pensionua dhe e kam trashëguar si art nga të parët e mi, e që tani e tutje e punojnë e tërë familja ime. Me po të njëjtin zanat është marrë edhe gjyshi im, Selim Mula, mik, bashkëluftëtar dhe ideolog i Bajram Currit. Familjarisht e kemi punuar këtë zanat në Gjakovë dhe në Shkodër. Ta njohësh traditën e plisit është nder. Djali im, Fisniku, që studion për master në Berlin të Gjermanisë, di të bëjë plisa. Pas lufte edhe unë u mora intensivisht me punimin e plisave, duke e bërë veprimtari të parë profesionale dhe ekonomike familjare”, thotë ai.

PSE GJAKOVA ISHTE E LIDHUR ME LDK-në DHE ME PLISAT?

Duke folur për ecuritë familjare, planet e punës dhe perspektivën, Sahit Mula ka pohuar se në familjen e tij më shumë flitet për LDK-në sesa në degën e LDK-së në Gjakovë.

Ai e thotë me keqardhje këtë gjë, meqë dikur Gjakova ishte qendër e LDK-së për Kosovën dhe tani ka mbetur në fund të pusit.

“Jemi familje e njohur në Gjakovë dhe për çdo gjë diskutojmë deri vonë pas mesnate. Më shumë diskutojmë ne në familje për LDK-në sesa që diskutohet në Kryesinë e Degës së LDK-së në Gjakovë!

Kam punuar në shumë funksione ekonomike dhe e kam vënë kokën në rrezik qindra herë për të mirën e popullit, por kurrë s'kam dashur të fitoj pa djersë. Shtëpinë ku jetoj e kam trashëgim nga gjyshi, Selimi. Gjyshi ka qenë i dënuar tri herë me pushkatim, por ka dashur fati nuk është ekzekutuar, sepse, falë mençurisë së tij, ka arritur që çdo herë të del nga rrethi i plumbit.

Në vitin 1994, presidenti i atëhershëm i Shqipërisë, Sali Berisha, e ka dekoruar gjyshin tim, Selim Mulën, me dekretin e presidentit të Shqipërisë, si pjesëmarrës i revolucionit të vitit 1924 në Shqipëri. Dekreti është dhënë me shkrim, ndërsa për veprimtarinë e gjyshit ka dokumente edhe në arkivin e Vjenës”, thotë Sahiti, i cili prinë në sistemim profesional ekonomik në institucionet e Gjakovës.



Sahit Mulën e kanë vizituar shumë kureshtarë

NGA 4 PLISA MBETËT VETËM 1 EURO FITIM!

Për ta bërë një plis duhen 16 procese pune. 20 orë punë nevojiten për lënurjen 700 gramë lesh, si lëndë e parë e plisit.

Andaj, duke treguar për fitimin nga plisi, Sahiti ka shpjeguar se nga një plis i shitur mbesin vetëm 25 centë fitim!

“Kur llogaris fitimin 25 centë nga një plis, d.m.th., nga katër plisa të shitur mbetet fitim një euro!

Mirëpo, duhet punuar, edhe pse fitimi është shumë i vogël.

Ne, si familje, plisin e punojmë qe 106 vjet.

Të mirat e plisit janë të shumta:

E para, e ruan kokën dhe flokun nga dielli, por edhe nga të ftohtit. Por, të gjithë plisat nuk e kryejnë këtë mbrojtje njëjtë. Disa plisa të djersitit.

Plisi i Gjakovës është më i njohuri në trojet shqiptare dhe veçohet për mos djersitje të kokës.

Në Gjilan, para gjashtë vjetësh, një burrë më tha: “Kam plis, por nuk e barti, ngase ma djersitë kokën!”.

la dhashë plisin tim dhe kurrë më nuk i është djersitur koka.

Plisin të cilin e punoj unë është i punuar në mënyrën që e ajros kokën, d.m.th., me një lloj filtri.

E, pastrimi i leshit e luan rolin vendimtar të ajrosjes...

I punoj dy lloj plisash: plisin gjakovar dhe plisin tiranas”, tregon Sahiti.

Ç'LLOJ PLISI BARTET NË TROJET SHQIPTARE?

Në Kosovë, sipas Mulës, barten tre lloje të plisave: Plisi i madh, i vogël

dhe me maje. Ky, i fundit, bartet në Rahovec.

Kemi plisa të Lumës, të Korçës dhe plisa të Shqipërisë së Jugut.

Në një panair, të organizuar në Gjakovë, kanë qenë të ekspozuar të gjitha llojet e plisave.

Plisi tash për tash bartet më së shumti në Anamoravë, në Rogovë të Hasit, në Drenicë dhe në Malishevë.

Dhe, duke treguar për shitjen e plisave, Mula thotë:

“Sot, mesatarisht në ditë shiten rreth 10 plisa. Këtë e dëshmon edhe reduktimi i zanatlinjve, i cili ka rënë nga 22 në 6 sish, sa edhe janë tash aktiv.

Shitja e madhe e plisave ka evoluar në kohën e pajtimit të gjaqeve dhe periudha deri në vitin 1998. Ka pasur kërkesa për blerjen e plisit edhe për ditën e Pavarësisë. Dhe, kam bërë edhe një risi në këtë drejtim: E punoj plisin me shqiponjë dhe me shkronjat UÇK.

Sidoqoftë, ka shumë të dhëna që fliten për plisin dhe njëra ndër to është se sa më shumë që është ndaluar, aq më shumë është bartur! Po ashtu, është edhe thënia se plisi është për të mbuluar zinë kombëtare...

Prandaj, të flasësh për plisin është histori e gjatë, me shekuj, të cilën nuk di ta shpjegojë askush, por ka të dhëna që burojnë nga informacione të ndryshme, të lashtësisë se plisi bartej edhe nga ilirët”, thotë në fund të bisedës sonë Sahit Mula, i cili këtë zanat e ushtron në shtëpinë e vet.

P. S.

Sahit Mula vdiq në shkurt të vitit 2017, në Gjakovë

Safet Krivaça



Si u korit Behgjet Pacolli për 5 euro?

Ka vite që në opinion qarkullon një batutë për një fëmijë lypsar dhe Behgjet Pacollin...

Një fëmijë kërkonte lëmoshë para hotelit të Behgjet Pacollit në qendër të Prishtinës. Dhe, teksa kalimtarët shkonin e vinin, ndërkohë vjen Behgjeti dhe fëmija ia zgjat dorën. Behgjeti, e që në atë kohë kishte pozitë shumë të mirë në pushtet, fut dorën në xhep dhe ia jep lypësit pesë euro.

Lypësi i merr paratë, ndërkohë i thotë zotërisë:

"S'guxoj t'i çojë në shtëpi se më mbyttë baba!"

"Thuaj m'i ka dhënë Behgjet Pacolli dhe nuk do të të rrahë!", ia kthen ai. "Nëse i them kështu më mbyttë krejt!", ia kthen fëmija.

"E, pse?!", e pyet Behgjeti.

"Babi do më thotë se Behgjet Pacolli nuk koritet me pesë euro! Ai do t'i jepte 50 euro!", ia kthen fëmija.

PSE KUR LIND FËMIJA I THONË PASTË FAT?

Fëmija kur lind shtëpisë i jep berqet, tamam qysh kanë thënë dikur "kur

fëmija është i hajrit të bën çirak, e kur është i sherrit ia sheh sherrin tërë mëhalla!"

A u kujtohet kur erdhi presidente Atifete Jahjaga? Me zarf u bë presidente! Pra, zonjë me fat! Madje, ishte kohë krize për postin e presidentit të shtetit, e nuk i binte askujt pozita tamam.

E, kur ambasadori amerikan Dell e hapi zarfin, fitoi presidentja Jahjaga. Erdhi në postin më të lartë një grua që nuk e njihnte kush, apo pakkush...

JA COFË GOMARI JA VDES MBRETI!

Shkon Nastradini në treg të bagëtive. Fillon t'i pyes rend shitësit e gomarëve sa ky e sa ai. Por, njëri nga gomarët shitej me çmim shumë të ulët.

"Pse ky gomar shitet për gjysmë më lirë?!", e pyet shitësin Nastradini.

"Ky është babai i gomarëve. Të gjithë kuptojnë nga diçka, e ky nuk merr vesh hiq!", ia kthen shitësi.

"Unë po e blej bash këtë gomar dhe për pesë vjet kam me e mësuar me fol!", ia kthen Nastradini.

Dhe, pasi ia jep paratë, Nastradini e

merr gomarin e niset për në shtëpi, ndërkaq shitësi me paratë në xhep shkon drejt e te mbreti dhe i thotë: "Nastradini e bleu gomarin tim dhe tha se për pesë vjet ka me e mësuar të flasë!"

Mbreti i thotë shitësit: "Shko te Nastradini dhe thuaj të vjen te unë menjëherë!"

E, kur Nastradini arriti te mbreti, ai i thotë:

"A je ti që e bën të flasë gomarin për pesë vjet?"

"Po", i thotë Nastradini.

"Sa para kërkon që ta mësosh gomarin të flasësh?"

"100 lira".

Mbreti ia jep paratë, kurse Nastradini shkon drejt e në shtëpi. Gruaja, posa e sheh në oborr me gomar, i del para. "Sa e bleve gomarin, o burrë?", i thotë. "Lerë që e bleva shumë lirë, por m'i dha mbreti edhe 100 lira! I premtova mbretit që brenda pesë vjetësh kam me e mësuar me fol gomarin!"

"E, si mësohet me fol gomar, o burrë?!"

"Grua, për pesë vjet ja cofë gomari ja vdes mbreti!"

Sokol Murturi

Unioni i bizneseve shqiptaro-gjermane

UB në udhëheqjen e Fadil Abdullahut takohet me shumë afaristë nga Kosova

Unioni i Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Gjermani ishte i ftuar në Konventën e pestë të Industrisë së Drurit që u mbajt në Prishtinë të enjten më 8 dhjetor, ku kishin ekspozuar produktet e tyre dhjetëra prodhues të drurit nga Kosova.

Pjesëmarrës ishin edhe përkrahësit e shoqatës dhe donatorët, drejtori i Zyrës për Zhvillim Ekonomik të USAID-it në Kosovë, zonja Joshua Mike, udhëheqësja e Projekteve nga GIZ zonja Elizabeth Hobl, ministrja e Industrisë dhe Tregtisë, zonja Rozeta Hajdari.

Të pranishmit i përshëndeti kryetar i Shoqatës së Përpunuesve të Drurit të Kosovës, zotëri Sheqer Ukaj dhe drejtoresha ekzekutive zonja Arieta Vula Pozhegu.

Në këtë Konventë, Unionin e Bizneseve (UB) e ka përfaqësuar drejtori ekzekutiv zotëri Fadil Abdullahu i shoqëruar nga zyrtarja ekzekutive e zyrës në Prishtinë, zonja Yllresa Shala.

Po ashtu, zotëri Abdullahu ishte pjesë e panelit ku u diskutua për industrinë e drurit, potencialin dhe eksportin.



Drejtori Abdullahu pasqyroi objektivat e Unionit të Biznesit si dhe mundësinë që përmes UB kompanitë të mund të krijojnë qasje në plasojnë prodhimet dhe shërbimet e tyre në Gjermani.

Gjithashtu, në panel u diskutua edhe për standardet dhe prodhimin e Kosovës, dedikuar për eksport që Kompanitë në fjalë t'i përmbusheshin të gjitha kriteret e Bashkimit Evropian.

Kjo formë e organizimit u mendua që gjatë vitit të ardhshëm, më konkretisht gjatë muajve maj-qershor, të organizohet një formë e tillë e prezantimit të kompanive dhe produkteve të tyre edhe në Gjermani, por duke përfshirë edhe anëtarë të UB, që veprojnë në Gjermani.

Për këtë çështje, kishte dakordim të plotë për mbështetjen edhe të USAID, GIZ, Institucioneve relevante dhe shoqatës së përpunuesve të drurit nga Kosova në

një organizim të përbashkët në Gjermani, duke e zgjeruar pjesëmarrjen edhe me sektorë tjerë.

Gjatë kësaj Konvente, përfaqësuesit e UB u takuan edhe me shumë afaristë nga Kosova të cilët e kanë për synim tregun e Gjermanisë.

Madje, disa nga ta tashmë përmes anëtarëve të Unionit të Biznesit janë aktiv në tregun e Gjermanisë. Interesimi për tu bërë pjesë e Unionit të Bizneseve përmes zyrës së sapo themeluar në Kosovë ishte i theksuar nga shumë të pranishëm.

Krijimi i urave të kontaktit mes anëtarëve të UB në Gjermani me ato në vendlindje është njëra nga objektivat e rëndësishme në strategjinë e UB.

**Erfolg verbindet!
Suksesi krijon lidhjet!**





Vajzat i falë Zoti e i merr dreqi!

Bash kur mendova se e gjeta djaloshin e ëndrrave të mia dhe po prekja parajsën me dorë, ndodhi zhgënjimi im më i madh në jetë dhe u binda se ai nuk më kishte dashur kurrë sinqerisht, por thjesht kishte qenë një aventurë, ku kishte shfryrë epshin e tij, duke shfrytëzuar sinqeritetin tim.

“Jo më kot thonë: Vajzat i falë Zoti e i merr dreqi!”, kështu e fillon rrëfimin e vet Fitorja, duke përshkruar fatkeqësinë e saj në dashuri.

“Ndonëse dëshira ime ishte që t’u bashkëngjitëm shoqeve të mia në fakultet, edhe prindërit e mi nuk refuzuan.

Por, më propozuan të studioja diçka ku pas kryerjes së studimeve do të punësohesha më lehtë, sepse kanë ardhur kohë të vështira për t’u punësuar.

Kjo preferencë më përgjigjej edhe mua dhe pa një e pa dy u regjis-

trova në gazetari, meqë mendoja se pas përfundimit të studimeve më lehtë mund të punësohesha në njërën nga portalet tona që janë te ne, madje me shumicë. Dhe, pas kryerjes së studimeve, me ndihmën e babait u punësova në një portal të rajonit tonë, i cili veç pat filluar të lexohet e komentohet për shkrime të ndryshme.

**“PIKU”
DASHURIA
SI PREJ QIELLI!**

Prindërit ishin të kënaqur, sepse ato pak para që merrja në punë,

ua jepja dhe filloi të ndryshojë gjendja jonë materiale.

Por, befas në jetën time "piku" dashuria si prej qielli...

Fillimisht ngurroja, por duke menduar se po më hapen dyert e jetës dhe ai do të jetë djaloshi i ëndrrave të mia, vendosa që të shoqërohem me "Memin", kështu ia lash nofken unë, duke i pranuar komplimentet e tij si ndjenja të sinqerta.

Pastaj, ai nuk ishte edhe shumë i moshuar dhe kishte jetë të mirë materiale. Tek e fundit, edhe unë duhej të martohesha, andaj, thashë me vete, pse ta humbja rastin...

Dhe, në një rën nga ditët që ishim bashkë, e lamë të takoheshim pas orarit të punës. Parkimi i veturës së tij pranë caktit ku ishim marrë vesh nuk më la të hamendesh shumë.

E, pasi shikova anash në më shihte kush a jo, shpejt e shpejt hipa në veturën e tij. Veturës i dha gaz, ia lëshoi zërin CD-së dhe në një çast, pranë një grope, unë u përplasa mbi krahun e tij. Ai shpejt e shpejt më puthi dhe vazhdoi rrugën...

Në afërsi të një mali hyri në mesin e shumë lisave të mëdhenj. Desha ta pyesja çka kërkonte këtu, por goja nuk më punonte. Në ato çaste më shtrëngoi fort për beli, më puthi dhe gjinjtë e mi të paprekur m'i shtrëngoi fort...

Pastaj, m'i shpërthehoi kopsat dhe më zhveshi si të ishim në dhomë.

Dhe, nuk di çka kemi bërë tutje dhe sa kemi qëndruar aty, sepse isha krejt jashtë vetes...

KISHA MBETUR SHTATZËNË

Pas asaj dite thuajse çdo ditë takoheshim, e pak ditë kishte që nuk bënim seks.

Ndërkohë, fillova të ndjej ca ndryshime në organizmin tim.

Dhe, kur ato ia përshkrova një shoqeje, më tha se janë shenja shtatzënie.

Por, kur i thashë "Memit", ai e mori si shaka e jo realitet.

Më në fund, më tha:

"I gjendet ilaçi edhe kësaj pune!"

"Do të martohemi, a?", i thashë.

"Çfarë martese, bre?! Do të abortosh dhe pikë!", ma ktheu.

Por, nga urrejtja që ndjeva për të në ato çaste, më nuk shkela në pragun e derës së punës. Po ato ditë, me ndihmën e po të njëjtës shoqe, kreu abortin dhe tash sillem poshtë e lart, pa kurrfarë vullneti për jetë...

Jetmira Z.



Nuk e dua emrin Yll, e dua Shaban!

Nuk e dua emrin Yll, por e dua Shaban. Nuk është mahi, por bëhet fjalë për djaloshin, i cili tash është 22 vjeç, e me veshje dhe pamje duket shumë më i moshuar.

Fjala është për Yll Raçin, nga Podujeva, i cili ka stil të veçantë të veshjes dhe të jetesës. Personat me të cilët shoqërohet Ylli janë jo moshatarët e tij, por njerëz të moshës 70-80-vjeçar.

Ai nuk del me shokë në kafene, të gjithë ata i fton t'i bashkohen në odën e tij në fshat.

Dhe, meqë jeta në qytet nuk i pëlqen, ai ka zgjedhur të bëjë jetë si në të kaluarën, e pa përtesë merret edhe me bagëti.

Thotë se së kudo që shkon plisin nuk e largon nga koka, sepse do që t'i ruajë vlerat e kombit tonë.



Gruaja nuk ma do nënën!

Kur i thashë gruas “Dua me marrë nënën me jetua me ne se ka mbetur e vetme”, më tha: “Shtëpia jonë nuk është shtëpi e pleqve!”.

Ka shumë vjet që jetoj në Gjermani. Dhe, deshi Zoti e u njoha me një vajzë shqiptare, që jetonte në qytetin ku jetoja unë, e së cilës edhe i pëlqeva shumë. Dhe, qe tre vjet jemi martuar. Por, halli im është se në Lipjan e kam

lënë të vetme, sepse vëlla nuk kam. Ajo herë-herë shkon te motra, por nuk po mund të rrijë gjatë, sepse nuk rrihet gjithmonë te dhëndri. Dhe, kur i thashë gruas se dua ta marrë nënën në Gjermani, më tha: “Shtëpia jonë nuk është shtëpi pleqsh!”. U ndala, e shikova gjatë dhe në një moment më shkoi mendja t’i them: “Hajt, baju, shko kah të duash!”. Por, nuk nxitova dhe u ndala. Dhe, mirë bëra që u ndala, sepse po të veprojta ashtu, martesja jonë do të përfundonte po atë ditë. Megjithatë, jam në hall: Si të veproj me nënën e cila më ka rritur me shumë mundime?

Në anën tjetër, nëna po jeton në vetmi dhe një Zot e di si i kalon ditët... Sidoqoftë, do pres edhe naj ditë se mos gruaja ndërron mendjen ose do të ndahem, sepse po më brenë ndërgjegjja ndaj nënës, e cila të vetmen shpresë në jetë e ka në mua... Por, më habit fakti pse femrat si gruaja ime janë pa ndjenja ndaj familjes? E, te nëna e vet shkon thuajse çdo javë, meqë nuk është shumë larg nga qyteti ku jetojmë ne. Ndërkaq, për nënën time as që bren-goset pse ajo jeton e vetme... Kurse, mua po më brenë ndërgjegjja dhe jam në luftë me vetveten...

Vigan Xhemshiti, Gjermani

remos® KA PUNË PËR TY!



Çka ne po kërkojmë është: Pizzamen, Kuzhinier, Barista, Kamarier



Aplikuesit duhet të kenë njohuri të gjuhës Gjermane dhe Angleze

Vendndodhja:
Frankfurt, Këln, Koblenz, Wiesbaden,
Westerwald, dhe Urmitz.

Na kontaktoni ne info@remos-restaurants.de



remos_restaurants

| info@remos-restaurants.de

| www.remos-restaurants.de



Skamje po, por jetë më të mirë se në Kosovë s'ka kund!

Më kujtohet një storje e një burri me mustaqe të gjatë deri ne vesh, në kohën e grevës së minatorëve në vitin 1989 në Kosovë, që nisi në "Trepçë" e u përhap në tërë Kosovën.

Në vitin 1989, 1300 minatorë të Trepçës u futën në grevë urie në zgafellën e horizontit nëntokësor të minierës në Mitrovicë, në mbrojtje të autonomisë së Kosovës, duke aktivizuar rezistencën gjithëpopullore. Atëbotë, një storje e xhiruar kishte në fokus një minator grevist me mustaqe

deri në vesh, duke i rënë të fikët në mesin e grevistëve të tjerë.

E kur e shikova mirë, ai ishte fqinji im, S., që natën vinte në shtëpi e flinte, e kah mëngjesi shkonte te shokët, por kjo ndodhte në një minierë tjetër, e jo në "Trepçë".

E, pas përfundimit të grevës së urisë së minatorëve, rastësisht takova fqinjin tim. E pranoi se nuk ishte alivanosur, por e kishte bërë me qëllim që ta bënte më tronditëse gjendjen në Kosovë...

**S'KA CENT NË XHEP,
KURSE PI MAKIATO
E DUHAN "MARLBORO"!**

Dhe, nejse...

Sot, me të hyrë në kafene për kafen e mëngjesit, pas meje hyn një mesoburë nga mosha dhe ulet te shokët e tij. E, posa ulet, kamerieri i sjellë kafen. Ndërkohë, vjen një shitës cigaresh

dhe shokët ia blejnë një pako duhan. Shokë se jo mahi, them me vete.

Po, ku ka tjetër vend në botë që pa asnjë cent në xhep njeriut t'i vijin kafja dhe cigaret "Marlboro"?!

Dhe, në këtë turrë e marrë një tost për mëngjes dhe e pyes pronarin e lokalit: "Si je? Si kalove gjatë pandemisë, sepse të ka rënë shumë ta mbash mbyllur lokalin?"

"Ka mbetur me thënë mirë, se unë shumë mirë jam! Pasha qato ditë të pandemisë, se kam fjetur e jam shkri gjumë!

Në lokalin tim i lëshonim perdet, me shokë pinim kafe, në mbrëmje luanim domino deri vonë, i komentoni debatet: ai e pat keq e ai mirë, ai bën e ai s'bën, e kështu me radhë.

Pra, çdo gjë e ka lezetin e vet...

Andaj, jetë më të mirë se në Kosovë nuk ka askund...

S. Murturi

MARITIM
RESORT MARINA BAY



Mandarine Restaurant by Marina Bay
+35533410000
+355696041000

Lime Lounge by Marina Bay
+355696041001
info@marinabay.al
www.marinabay.al

Adresa: Vlorë, Shqipëri

"I kam bërë 10 fëmijë pa u kënaqur kurrë seks!"

Deri në vitet 70 të shekullit që e lamë pas, ligji i pashkruar i kanë detyruar çiftet që marrëdhënia e parë seksuale të bëhet në natën e parë të martesës. Andaj, edhe pse vajza ka qenë e preokupuar se si do të zhvillohej ceremonia e dasmës, është dashur, me patjetër, t'i dorëzohet burrit në natën e parë të martesës.

Ç'thonë të anketuarit tanë në këtë temë?

**ARANITA, E MARTUAR, 35 VJEÇE:
SEKSI NUK KUSHTËZOHET - JA SOT JA HIQ!**

- A duhet bërë seks, patjetër, në natën e parë të martesës, a?! Kjo është një nga budallaqet e kohës, e që, deshi Zoti, tash është hequr nga mendja e njerëzve.

Sepse, seks duhet bërë kur ke ndjenjë për të, kur ta do shpirti e trupi. Pra,

nuk është një gjë që kushtëzohet: ja sot ja hiq!

BERATI, I MARTUAR, 33 VJEÇ:

DUHET ME QENË BURRË ME U PËRMBAJT...

- Mendoj se duhet me qenë burrë dhe me karakter të fortë që të përmbahesh, që të presësh me vjet për të bërë seks në natën e parë të martesës! E tash, meshkujt e moshës sime, sapo të njihen me një femër, menjëherë kërkojnë që të shkojnë në shtrat me të në ndonjë motel, hotel a gjetiu. Por, edhe femrat mezi presin që të shkojnë në dhomë, sepse seksi i parë në natën e martesë që moti është hequr nga rendi i ditës...

**FATIMJA, E NDARË NGA BURRI, 71 VJEÇE:
NË NATËN E PARË TË MARTESËS NUK E KAM HEQUR SHAMINË NGA FYTYRA!**

- Mua, në natën e parë të martesës, burri nuk më lejoi të hiqja shaminë nga fytyra, sepse as nuk e kisha parë e as nuk më kishte parë deri atë natë. Për më keq, merrni me mend se çfarë seksi kemi bërë: më shumë ishte një torturë sesa kënaqësi!

Andaj, një pas një i linda 10 fëmijë dhe kurrë nuk di çka është kënaqësia në seks, sepse seks bënim kur flinin fëmijët dhe nuk nxirrim zë nga goja, meqë fëmijët zgjoheshin nga gjumi...

FEJAZ K., BABA I 7 FËMIJËVE, 75 VJEÇ:

AH, PASHA QATË KOHË, PO E NGACMOVE FEMRËN KRISTE PUSHKA!

- Ah, pasha qatë kohë! Askush nuk ka guxuar ta dhunojë askënd, sepse të nesërmen ka kërcitur pushka, e jo si sot që çdo ditë ndodhin ngacmime seksuale, e edhe dhunime, madje me fëmijë adoleshentë!

E tash, sa herë dalë me bijat e mia në ndonjë restorant, njerëz të pandërgjegjshëm, pa kulturë ua ngulin sytë dhe nuk kanë aspak marre që unë, plaku, jam me to!

PËR FUND

Të anketuarit e moshuar mendojnë se dikur ishte më mirë, se s'kishte ngacmime seksuale, s'kishte dhunime, se seksi i parë bëhej në natën e martesës. E, të anketuarit e moshës së re habiten me atë se seksi i parë është bërë vetëm kur ka ardhur koha e natës së parë të martesës...

Shtrohet pyetja: Cilët e kanë më mirë?

Diturie Haxhaj

BOOM



*Kush ia dha
Shpat Kasapit
50 mijë euro
bakshish?*

*A ka kushte
për aktrim
në Kosovë?*

*Çka i porositë
Fatmir Spahiu
fëmijët?*

**Arbnora
Ademaj**
*yll me shpirt
të mirë*

A woman with long dark hair, wearing a black high-necked, long-sleeved dress, stands in a room with purple and gold lighting. She is smiling slightly and looking towards the camera. The background features arched doorways and a decorative table with a glowing purple object.

***Arbnora
Ademaj***
*yll me shpirt
të mirë*

Arbnora Ademaj është ish-misi kosovar, që bukurinë shqiptare e përfaqësoi edhe në gara të mëdha bukurie me karakter internacional. Përtej fytyrës e trupit të bukur, përtej imazhit të vajzës së ekranit, serialeve e spektaklit, Arbnora është edhe vajzë shpirtmirë. Kështu e përshkruajnë ata që e njohin, por edhe gazetarët që me vite janë marrë me të, me zhvillimet në karrierës e jetës së saj.

Modelja dhe aktorja e njohur, Arbnora Ademaj, është pjesë e serialit turk "Kirik Hayatlar". Sipas kritikës në Turqi, ajo ka shkëlqyer me performancën si aktore. E, seriali ka marrë pëlqyeshmëri të madhe edhe në Kosovë.

Arbnora Ademaj, aktorja e njohur shqiptare që po shkëlqen në fushën e aktrimit edhe jashtë vendit, ka ardhur në "Dance With Me", Edicioni VII në "TV Klan", si konkurrenente.

Ademaj ka treguar se i ka lënë dy projekte të rëndësishme në Turqi, për t'u bërë pjesë e spektaklit të valëzimit.

Në spektaklin "Dance With Me", performanca e ish-"Miss Kosovës", modeles dhe aktorese së njohur, është vlerësuar pozitivisht, duke e plotësuar edhe më tej spektrin e talenteve të saj.

Ermal Mamaqi, si pjesë e panelit vlerësues, e ngriti në pedestal aktoren, duke e konsideruar si gruan më të bukur shqiptare.

Sidoqoftë, ylli i botës së spektaklit, shumë shpejt do të jetë në një serial të ri që do të shfaqet në "Netflix".

N. N.



A ka kushte *për aktrim në Kosovë?*



Aktori Kushtrim Hoxha u lind në Gjakovë në vitin 1978. Studimet i nisi në Universitetin e Prishtinës, në Akademinë e Arteve, në klasën e profesor Faruk Begollit.

Gjatë luftës shpërngulet në Amerikë, ku vazhdon studimet për aktrim.

Gjatë viteve në vazhdim Kushtrimi mori pjesë në disa shfaqje në Teatrin Kombëtar të Kosovës, në Teatrin "Dodona", në Teatrin e Gjakovës, si dhe luajti edhe në serialin vendor "Familja moderne".

Kushtrimi njihet edhe si këngëtar dhe deri më tani ka realizuar disa këngë, si, bie fjala, "Kopshti", në duet me Hana Cakulin, pastaj këngën "T'i them heshtjes tane mjaft" etj. I ka përfunduar studimet për master në aktrim në Universitetin e San Diegos në Kaliforni dhe është i punësuar në Teatrin "The Old Globe" në San Diego. Momentalisht jeton dhe vepron në Nju Jork.

Ai vite më parë pat deklaruar në një prononcim të tij se punë për aktorët s'ka në Kosovë, meqë pak rëndësi i kushtohet kulturës te ne, për të mos thënë fare.

Ai pat deklaruar se aktori duhet t'i krijojë vetes kushte, por në rrethanat e tashme në Kosovë është vështirë të krijosh diçka të mirë, diçka për qejfi.

Çka i porositë Fatmir Spahiu fëmijët?

Aktori, Fatmir Spahiu, i njohur si personazh Bufi, në opinion ka respekt të madh si aktor.

Ai, ditë më parë, në një emision televiziv foli për bullizmin, të cilën e kishte përjetuar veçanërisht si fëmijë.

“Po, jam bullizuar, sidomos në fëmijëri... E di që bullizmi është bërë aktual, prandaj u bëj ftesë dhe i inkurajoj, sidomos, fëmijët e shkollës fillore dhe ata që janë në adoleshencë të hershme, të ndihen mirë për atë që janë dhe atë çfarë përfaqësojnë”, thotë ai.



Kush ia dha Shpat Kasapit 50 mijë euro bakshish?

Shumë nga këngëtarët tanë këndojnë dasma, sepse leverdia është e mirë.

E, njëri ndër ta është edhe Shpat Kasapi, i cili, pa fije dyshimi, është shumë i adhuruar nga publiku. Ai këndon kudo ku ka shqiptarë dhe paguhet mjaft mirë. Dhe, në një pyetje se a merr bakshish në dasma, përgjigja e Shpatit ishte se në dasma ka marrë shumë bakshishe, madje deri në 50 mijë euro.



★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

DARKA E KRISHTLINDJEVE
CHRISTMAS DINNER

DECEMBER

24

SATURDAY

Për rezervime:

+383 49 30 10 30 | +383 45 60 70 70



Si u bëra shoqe me dashnoren e burrit?

Jam 55 vjeçe, e martuar. I kam katër fëmijë, dy djem e dy vajza. Unë si moshë jam pesë vjet më e vjetër se burri im. Kemi jetë të lumtur, por një mesazh që i erdhi tim burri në telefon e ndryshoi rrjedhën e çdo gjëje...

Kur ishim të rinj, unë 25 e ai 20 vjeç, u njohëm në punë. U dashuruam, edhe pse unë isha më e vjetër se ai. Në atë kohë më njihnin si femër shumë e bukur dhe, mbi të gjitha, rridhja nga një familje e pasur. Arsyet e vërteta pse burri im u martua me mua as nuk i di dhe as nuk jam kurioze t'i di, por në atë kohë ishim çifti më i bukur i qytetit. Nuk vërehej se isha më e vjetër, meqë jam trupvogël dhe ai ka një fizik prej atleti. Është i gjatë, edhe sot që i ka mbushur 50 vjet. Mes nesh gjithmonë ka pasur

mirëkuptim dhe nga ana ime, një dashuri të pafundme, që besoj se do të vazhdojë deri në përjetësi. Dhe, nga ajo dashuri e madhe lindën rresht njëri pas tjetrit katër fëmijët tanë. Kjo ishte gjëja më e bukur në botë dhe, njëkohësisht, ajo që do të bënte që mes nesh ndryshimi i moshës të dukej e të binte shumë në sy.

SI E LASHË VETEN PASDORE?

Meqenëse e dashuroja shumë dhe fëmijët që i kisha ishin pasuria më e madhe për mua, ua kushtova jetën

fëmijëve. E di se të gjitha nënat kështu bëjnë, por unë po e them në kuptimin se e harrova veten fare. Harrova se duhej t'i kushtoja rëndësi bukurisë së jashtme. Nga ana ekonomike ishim shumë mirë. Mirëpo, nga ai bollëk "pësova unë", që do të thotë, edhe pse lodhesha shumë, kisha shumë oreks dhe u trasha shumë, me mbi peshë normale, ndërsa burri im nuk kishte ndryshuar aspak. Madje, koha kalonte e ai zbukurohej. Fëmijët u rritën dhe morën drejtime të ndryshme, secili me fat të vetin...

AH, MESAZHI NË TELEFON!

Por, historia ime fillon kur i gjeta një mesazh në telefon. Ishte një pasdite e qetë tekta rrinim bashkë. Ai u ngrit për të bërë një dush dhe harroi telefonin në tavolinë. I erdhi një mesazh. E hapa pa të keq që ta lexoja.

“Po të pres te vendi. Eja shpejt se nuk kam shumë kohë”. Nuk e kishte shkruar emrin dhe mesazhi ishte me numër. Nuk e dija a ishte femër apo ndonjë shok, kështu që nuk nxitova. E shënova numrin dhe mendova se po veproja gabim, por ky mendim u këput në mes nga prania e burrit.

“Uh, si e harroj edhe unë vend e pavend telefonin! Më mori njeri?”, më tha. “Nuk e di! Sa u ula edhe unë se isha në dhomën e gjumit”, e gënjeva për herë të parë në jetën time.

E hapi telefonin dhe sa pa mesazhin tha se duhej të dilte se po e kërkonte një shok.

“Po ne sikur do e kalonim pasditen bashkë?!” ia ktheva.

“Eh, ku të lënë shokët!”, më tha me butësi.

Dhe, butësia e tij më bënte të harroja se si isha. Më bënte të harroja se ndoshta ai më tradhtonte dhe, madje, nuk më shkonte në mendje se do të kishte sy për ndonjë tjetër.

E kisha numrin, por nuk mund t’i telefonoja. Më dukej se po të ishte, me të vërtetë, ndonjë shok, do të isha unë ajo që po bëja gabim e nuk po e besoja. Nejse, kurioziteti ishte më i fortë se unë. Nuk e mora atë ditë, por nja dy ditë më pas dhe ashtu, siç mund ta kuptoni, në telefon më doli një femër. Ajo, sa e mora, u përgjigj. E mbylla telefonin pa folur dhe menjëherë para meje u shemb ajo lumturi shumëvjeçare.

Tani nuk e dija në duhej t’i thosha apo jo tim shoqi për çfarë kisha zbuluar. Vendosa të zbuloja se cila ishte ajo femër e më pas të ndërmerija ndonjë veprim.

DASHNORJA E BURRIT ISHTE MË E BUKUR SE UNË!

Pas shumë mendimeve, thura një “plan”. E mora në telefon dhe i thashë:

“Alo, mirëdita!”

“Mirëdita! Kush jeni?”

“Oh, më fal, i paskam rënë gabim. Ju, kush jeni?”

Për çudi, ajo ma tha emrin. Ndoshta nuk do ta mendonte kurrë kush isha dhe për këtë u tregua shumë naive. Ditën e parë kur e mora vesh, nuk bëra gjë. Të nesërmen, vendosa të shkoja ta shihja se si ishte. Hyra në parukeri ku më tha se punonte dhe kërkova të bëja një krehje. Ndonjëherë mendoja se ajo do t’më njihte, por jo, ajo as që kishte idenë se kush isha.

Ishte vajzë shumë e bukur, e re, nja 25 vjeçe. Kishte çdo gjë që unë nuk e kisha. Kishte trup të përsosur dhe, për më tepër, ishte shumë e bukur.

Kur shikoja ndryshimin tonë në pasqyrën e parukerisë, më zihej fryma...

“Qenkeni shumë e bukur!”, i thashë.

“Faleminderit! Edhe ju qenkeni e bukur!”, ma ktheu.

Por, e dija se këtë ma tha kot...

NË KAFE ME DASHNOREN E BURRIT...

Dhe, që nga ajo ditë unë shkoja shumë shpesh në atë parukeri. Nuk i thashë burrit asgjë. Një ditë shkova pak më herët dhe ende nuk ishte hapur parukeria. Ajo po priste jashtë se ende nuk kishte ardhur pronarja. Unë, si gjithmonë, duke ndjekur nga pas atë. Bëra sikur më duhej një krehje.

“Ua, qenka mbyllur!”, i thashë.

“Është vonuar pronarja në trafik. Po ju, do të prisni?”

“Mezi po rri në këmbë, do hyj në kafe. Do të vish edhe ti?”, ia ktheva.

U ulëm të dyja në një tavolinë dhe brenda kisha frikën se mund t’më shihte im shoq. Në fakt, unë nuk e kisha problem se para meje në tavolinë ishte femra me të cilën burri im më tradhtonte.

Dhe, duke biseduar, po e pyesnim njëra-tjetrën për familjen.

“Sa fëmijë i ke?”, më pyeti.

“I kam katër fëmijë”, i thashë, por ndryshova vitet e tyre, që të mos e kuptonte, sepse mendoja se e dinte moshën e fëmijëve tanë.

“Po ti, a je e fejuar a e martuar?”, i thashë.

“Jo, jam e dashuruar, por ai nuk do të fejojemi. Është pak më i vjetër se unë me moshë”.

“Pak, a?”, i thashë unë.

“Edhe pak nuk është, por nuk ngjan me moshën që ka”.

“Pra, ai nuk paska qenë asnjëherë i martuar, meqë qenka i vjetër?”, i thashë, në rolin e zbulueses.

“Ka qenë më përpara, por tani jeton me prindërit dhe nuk po vendos të martohet me mua. Po unë edhe kështu jam mirë. Nga dashuria që kam për të mund të pranoj gjithçka”.

SI U BËRA SHOQE ME DASHNOREN E BURRIT?

Çdo fjalë e saj ishte si shigjetë për mua. E, si mund të durojë një femër që t’i thotë e dashura e burrit këto fjalë?

“Ti mbahesh mirë, je një nga klientet që vijnë më shpesh. Kushedi sa krenar duhet të jetë yt shoq që ka një grua që mbahet kaq mirë”.

“Po, është e vërtetë që më do shumë. Edhe pse jam e trashë, ai asnjëherë nuk ma thotë këtë”.

“Ti vetëm e trashë je, përndryshe në fytyrë je shumë mirë. Me pak palestër mund të jesh shumë në formë. Po deshe, eja atje ku shkoj unë”, ma ktheu.

“Por, a do të mund të dobësohem?”, ia ktheva.

“Sigurisht! Kam parë më të trasha se ti që janë bërë elegante”.

Dhe, vendosa të shkoja në palestër. Tani shkojmë bashkë dhe pimë edhe kafe bashkë. Në fakt, nuk ndjem aspak keq. Nuk e di pse, por ndoshta ngaqë ajo është një vajzë shumë e dashur e shumë e singertë.

Pas palestrës, trupi im është më në formë, por ende do shumë punë.

Por, e kam edhe hallin se po më pa im shoq me të do më keqkuptoj, por nejse, ai do mendojë se jemi njohur rastësisht në parukeri.

Nganjëherë mendoj të mos shkoj më te parukeria e saj dhe as në palestër, por më tërheq ajo si me magnet...

D. B.



8 vite sukses!

Këto ditë dhjetori, bëhen 8 vite sukcesi, që kur restoranti më i mirë i ushqimit të detit dhe atij italian, 'n'peshk' në Prishtinë, filloi punën me një përkushtim dhe shërbim cilësor ndaj mysafirëve dhe klientëve të tij besnikë.

Me këtë rast, restoranti unik i ushqimit të freskët të detit dhe ushqimit të mrekullueshëm italian 'n'peshk', falënderon të gjithë mysafirët e tij, me të cilët gjatë këtyre 8 viteve sa të vështira, por

edhe aq të bukura, u rrit, duke u munduar që të ofrojë çdo herë e më shumë një produkt cilësor, shërbim profesional dhe ushqim të shijshëm

Gjatë këtyre viteve pune të palodhshme, për restorantin 'n'peshk', mysafirët e shumtë, kanë ndarë momentet e tyre më të bukura të jetës, si ditëlindjet, fejesat, celebrimet, diplomimet e shumë e shumë evente të tjera...

Përjetoni dhe ju çaste të këndshme me ushqimin më të mirë të kuzhinës italiane dhe ushqimit të shijshëm të detit, duke e shoqëruar edhe me shumëllojshmërinë e verërave më të mira të markave të ndryshme botërore, në ambientet magjike të restorantit luksoz me traditë 8 vjeçare, 'n'peshk'

Rezervoni duke vizituar faqen zyrtare në Instagram @npeshk_restaurant_veternik



nPeshk

TERRACE



Kontakti:
045/840-850
045/233-211

Më kanë bërë sehire, nuk po më merr askush për grua!

Jam e re, e bukur, me krejt të mirat, por askush nuk më merr për nuse, edhe pse i kam vetëm 26 vjet. Më duket se dikush më ka bërë sehire...

Kam qenë në lidhje dashurie me një djalë dhe isha shumë e lumtur. Ishim afër fejesës, por në moment ndërroi gjithçka dhe ai u fejua me një tjetër, e mua më la.

Dhe, kam vuajtur shumë derisa e kam harruar. Megjithatë, ende më rri në zemër dhe e kujtoj...

HALLA MA PRISHI FEJESËN!

Por, t'i kthehem edhe një herë të kaluarës sime. Para se me u njoftua me të kam qenë te një grua me ma ka shikuar filxhanin e kafes. Më tha ke me u njohë me dikë, por në atë familje është një person që të njeh

dhe ruaju prej tij...

Mendoj se halla ime ishte ajo, meqë edhe jeton në atë familje. Shpesh kam pasur konflikt me të për sene banale... Dhe, nejtse...

Problemi që e kam tash është se prej atëherë jam munduar me e njohtë dikë tjetër, por nuk po kam sukses. Në fillim, kur njihem me dikë, puna ecë mirë, por shpejt prishet! Secili më thotë se nuk është i gatshëm për lidhje serioze.

Kështu më ndodhi edhe gjatë verës. U njoha me një djalë dhe u dashurova në të që në shikim të parë. Njohja me të erdhi pasi ma sugjeruan familja, e që e njihnin që moti... Edhe këtë herë fillimi ishte i mirë, por

shpejt u ftohë prej meje dhe më tha, si të tjerët, se nuk është i gatshëm për lidhje serioze. Konkretisht, më tha: "Je shumë e mirë. E meriton një më të mirë se unë!".

NUK PO MË DEL NAFKA, JAM NË SIKLET TË MADH!

Tash, pas gjithë atyre djemve që i njoha, më ka kapur një siklet i madh: Nuk po më del nafaka, çka të bëj?! Si me e gjet një person që më merr për grua?

Shkurt e shqip: Dikush më ka bërë sehire dhe po më pengon të martohem...

Ajmanja, Deçan



PARA

PAS



20 SEANCA

-13 KG

Qendrat e dobësimit 'Shkenda Dubova' janë ndër bizneset më të suksesshme të vitit. Duke filluar me një degë të vetme në Prishtinë, biznesi i Shkendës sharmante, ka kaluar kufijtë kosovar. Tani, qendrat e dobësimit gjenden edhe në Shqipëri, Gjermani dhe Zvicër, e njëkohësisht pritëse që të hapen edhe nëpër vende të tjera të botës.

Gjithsesi, suksesi i tillë vjen si rezultat i punës së palodhshme të Shkendës dhe stafit të saj, mirëpo edhe i shumë storjeve të suksesit, të qindra klientëve të kënaqur.

Kush thotë që një femër nuk është e denjë për biznes?!

Shkenda Dubova e dëshmon të kundërtën, duke qenë shembulli më i mirë i femrës kosovare të suksesshme.

Shumë mund të pyesin se si ndodhë i gjithë procesi i dobësimit tek këto qendra, me rezultate kaq të dukshme tek klientët? Çdo klient fillon me seancat e shkrirjes së dhjavit, përmes aparaturave më moderne, që janë në përputhje edhe me standardet evropiane të teknologjisë së dobësimit.

Kështu, klienti së pari i nënshtrohet një analize trupore, ku përcaktohen: masa dhjamore, masa hidrike, masa muskulore dhe skeletore, si dhe metabolizmi. Si rezultat i kësaj terapie, klienti humbet 5-8 kg në 10 seanca të plota dobësimi, me një reduktim të perimetrit deri në 10 cm, për vetëm 10 seanca.

I gjithë ky proces ndodhë falë këtyre aparaturave, karakteristikat e të cilave do t'i shohim në vijim:

- Perfect Body-Tunnel Sauna - Është një aparaturë e teknologjisë së fundit, dhe rezultat i një projekti të gjatë kërkimor, efikasiteti i së cilës është verifikuar shkencërisht në të gjitha aspektet mjekësore e teknike, pa efekte anësore, e po ashtu, edhe kuruese për shumë sëmundje. Kjo aparaturë funksionon duke aktivizuar molekulat e ujit, që përmirësojnë thithjen e oksigjenit, qarkullimin e gjakut dhe nxisin metabolizmin. Rrezet infra të kuqe të afërta dhe të largëta, kombinohen për të depërtuar në indet e lëkurës deri në 30% (6 mm nën epidermë), duke shpërbërë grumbullimin e yndyrës të lokalizuar në bark, vithe dhe kofshe. Në mjekësi, IR përdoren për shërimin e shumë sëmundjeve si: sëmundjet reumatike, sëmundjet degjenerative të nyjeve, gjendjet postraumatike (kryesisht sportistët), inflamacionet e hapësirave paranazale etj.
- Body Shape-Kabina e Shtrirë - Një tjetër pajisje që sjellë benefite të jashtëzakonshme për shëndetin, e në veçanti në humbje të peshës. Kjo aparaturë realizon një funksion të rëndësishëm në relaksim dhe detoksifikimin e tyre, duke larguar toksinat dhe acidin laktik. Benefitet kryesore të kësaj aparature janë:

- Riaktivizon metabolizmin dhe ndihmon në eliminimin e shtresave të tepërta dhjamore, duke eliminuar kilogramët, dhe duke ofruar rimodelimin e formës trupore;
- Lehtëson dhimbjet nga patologji të ndryshme, si dhembjen e kurrizit, nervit ishiatik, artritin, reumatizmin;
- Rritë qarkullimin e gjakut duke furnizuar kështu indet dhe çdo pjesë të trupit, me elemente ushqyese;
- Tonifikim i thellë;
- Përmirëson shëndetin e zemrës dhe ulë stresin;
- Përmirëson sistemin nervor;
- Zhdukë në mënyrë të ndjeshme celulitin duke eliminuar shtresat dhjamore;
- Ngadalëson efektin e plakjes, duke përmirësuar dukshëm elasticitetin dhe butësinë e lëkurës;
- Përmirësim i dukshëm i drenimit të toksinave dhe i lëngjeve;
- Detoksifikim i organizmit, rritje e forcës dhe fleksibilitetit;
- Lehtëson gjendjen e depresionit;
- Efekt analgjezik;
- Lehtëson dhimbjen dhe përmirëson lëvizjet te personat që kanë sëmundje reumatike, etj.

• Sauna Tradicionale nga Druri i Pishës - Është aparaturë ku përmes efektit termik të nxehtësisë, ndihmon në eliminim e shtresave dhjamore dhe humbjen e peshës. Disa nga benefitet e saunës me nxehtësi janë:

- Detoksifikim;
- Përmirëson qarkullimin e gjakut dhe ulë tensionin arterial;
- Humbje të peshës;
- Eliminon celulitin edhe nga zonat më delikate;
- Relaksim muskolor, etj.

• Pajisja e Dobësimit Intensiv (Ultra Sonik) - Kjo pajisje funksionon përmes valëve sonike të frekuencës 40000Hz, të gjeneruar nga sonda. Pasi valët hyjnë në trupin e njeriut, gjenerohet efekt intensiv goditës në qelizat dhjamore, si dhe lëvizje ndërmjet qelizave dhjamore, të cilat në mënyrë efektive djegin energji, dhe kështu ndodhë tkurrja e qelizave dhjamore. Ndërkohë, vibrimi i valëve sonike, shkakton ndikim intensiv midis qelizave, të cilat shpërthejnë menjëherë, duke zvogëluar numrin e qelizave yndyrore dhe arrijnë efektin e heqjes së dhjavit.

• Elektrostimulorët Muscular - Ky është procesi i fundit që bëhet gjatë një seance. Është një proces shumë i rëndësishëm, përderisa jeni duke shkrirë dhjavin, përmes elektrostimulimit, tonifikohet trupi, nuk e lë të varet dhe të qulllet trupi, si dhe stimulohen muskujt dhe ngushtohet perimetri.

Edhe pse je martuar, hija jote më ndjekë!

Ti nuk je më ajo që unë e doja! Ty dikur të shkonin të gjithë fustanet me buzëqeshjet e fytyrës! Tani ti je një tjetër, që shprehë frikë në fytyrë, kurse ajo që unë e doja ka vdekur përgjithmonë...

I tillë, si jam sot, isha qëkur i mbaj mend lulet dhe fluturat. Gjeja forcë të vrapoja pas tyre derisa i fusja në dorë. Lulet nuk mund të iknin, por fluturat kishin fuqi më të madhe se unë. Aq sa vrapoja për ta provuar fuqinë me fluturat, babai më thoshte mos mendo se janë vetëm dy krahë të lehtë, sepse aty është fuqia fluturuese.

EDHE PSE JAM BURRË, BABAI MË KONSIDERON FËMIJË!

Kur u rrita sa jam sot, isha ndalur në një stom toke dhe i shikoja lulet nëse kishte flutura. Babai më tha se unë sërish kisha mbetur fëmijë, siç kisha qenë dikur. Më tha se tash dalloj vetëm për nga gjatësia e trupit...

U dëshpërova shumë kur ma dha babai atë vlerësim dhe shpejt u ktheva në odë. Vura kokën mbi jastëkun prej kallëpi të kashtës së fortë, në kërkim të pushimit të mesditës...

Desha t'ia merrja inati babait, por mu hodh në kokë si një shkëmb i rëndë tregimi i tij se si ishte rritur jetim dhe

thashë se babai nuk e kishte jetuar rininë me prindërit dhe nuk dinte deri në cilën masë mund ta lëndojë fëmijën sikur bëri me mua...

Desha ta falja, sepse nuk kisha çfarë t'i bëja, ai edhe ashtu dukej i lodhur nga jeta e jo nga mosha. Flokun e kishte tamam sikur e mbaja mend në çdo kohë.

SHI NUK BINTE A JASTËKU ISHTE LAGUR!

E vendosa kokën në jastëk dhe për pak minuta ndjeva lagështinë në jastëkun prej kallëpi. Shi nuk binte, mendova në atë përgjumje.

Ah, më ranë lotët... E pash veten tek vrapoja një vërrie gurishte të mbushur lule dhe barë. E mbaja për dore dikë që nuk e kisha sot dhe, madje, më erdhi në mendje edhe emri i saj.

Pse t'ia merrja inati babait, kur unë, vërtet, nuk isha rritur?! Ky që jam sot isha edhe para dhjetëra vitesh!

Atë që e kisha ëndërruar me kokë mbi jastëkun e kallëpit e shihja ëndërr, por nuk di se kush ishte... Nuk di as pse qaja! Por, gjithnjë më dukej se isha penguar t'i përjetojta fluturat dhe lulet sikur dikur...

Andaj, ula kokën në jastëk dhe serish e ndjeva lagështinë e jastëkut.

Unë po qaja, sepse isha rritur në botën time të luleve dhe fluturave dhe doja të jetoja ende si fëmijë, vetëm brenda saj.

VETËM TI MË BESON, POR NUK JE MË PRANË MEJE...

Ti më beson, por ti nuk je këtu pranë meje sonte...

Ndjej si mund ta kallësh botën për një flutur.

Ndjej si mund të vdesësh për një dashuri. Ndjej sikur më thua ikim në qiell mbi ndonjë re që ka shi.

Kisha dal mbi kodër dhe i kisha shtrirë duart në drejtim të erës që m'i valëviste flokët, duke m'i mbyllur fladitë sytë.

Lutesha për ty... Por, nuk di edhe çka lutesha... Për ty më kishte zënë mbrëmja duke u lutur.

Mos ikë, qëndro këtu! – fola me zë, teksa jastëku po bëhej gjithnjë e më i lagësht...

Unë mbaja në dorë buqetën e premtuar, që kur të vinte ajo do t'i thosha se është jeta ime.

Por, ajo nuk erdhi. E ndjeva vetëm zërin e saj në valët e telefonit. Sidoqoftë, isha përmallur për zërin e saj.

Më fol diçka të bukur, të lutem! - i thashë.

Dhe, si fëmija që do të del sa më shpejt të dëshira e tij, i thashë se jam duke e pritur që të vjen e t'i merr lulet. I kam bërë buqetë dhe i kam lidhur shumë, që të mos ndahet asnjëra prej tubës...

Sa fëmijë që je! - më tha. - Unë jam tërë vaj e ti më thërret për lule! Unë qaj për ty, fle për ty, zgjohem për ty, por nuk po mund të të prekë!

Në këtë çast, ula duart dhe buqeta me lule sikur ra nga qielli në një humnerë të thellë. Më rrëshqiti nga duart sikur të mos kishte qenë kurrë në duart e mia.

Provoj të gjej forcën e shpëtimit. Por, ajo sërish më del para me fytyrën engjëllorë...

Andaj, edhe pse e martuar, hija e saj më ndjekë!

S. M.

Kompleksi Ulpiana Center – Lipjan

10%

ZBRITJE



Kompleksi Cima Tower – Ferizaj





Cilët njerëz bien shumë lehtë në dashuri?

Për disa shenja të zodiakut dashuria troket në derën e tyre shumë herë dhe, ndoshta, shumë më tepër se sa pritet...

DEMI

Për Demin, të biesh në dashuri është procesi më i thjeshtë dhe më i lehtë. Thur një mendim dhe e bën gjithçka magjike, sapo të gjejë personin që do t'i bëjë përshtypje.

Dhe, kjo ndodh mjaft lehtë, sepse Demi i do magjitë dhe përrallat dhe ka një tendencë për të idealizuar lehtësisht situatat dhe njerëzit.

Ai nuk dorëzohet derisa të gjejë personin e përsosur dhe çdo herë bie në të njëjtin kurth.

LUANI

Luani jeton për të rënë në dashuri. Nëse merr vëmendjen që kërkon, mund të bëjë gjithçka, por shpesh bie në dashuri me njerëzit e gabuar dhe zhgënjehet lehtësisht.

Megjithatë, asgjë nuk mund ta ndalë eksitimën dhe pasionin e tij derisa të gjejë objektivin e radhës dhe të bjerë edhe një herë, me fytyrë për tokë.

PESHQIT

Është shenja më e ndjeshme dhe emocionale e ciklit astrologjik dhe nuk bën aspak përshtypje që dashurohet lehtë.

I jep gjithçka personit për të cilin kujdeset, por ka nevojë për vëmendje, sepse sa jep gjithçka edhe lehtë mund ta marrë përsëri, nëse gjen më shumë mister dhe aventura diku tjetër.



DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Më mendojnë ëndrrat

Zonja magjistare, të përshëndes shumë. Jam 47-vjeçare, nënë e tre fëmijëve. Kam të kryer Fakultetin Filologjik dhe punoj. Përballem që një kohë të gjatë me ëndrra dhe ka kohë që nuk bëj gjumë të mirë. Më është prishur rehatia, por deri më tani e kam mbajtur në vete, e tash e dinë fëmijët e mi dhe burri se te unë po ndodh diçka...

Shumë herë burri më shikon me kureshtje se çka po ndodh me mua dhe kemi pasur edhe mosmarrëveshje kur unë rri zgjuar, sepse ai po dyshon që mua po më mundon diçka tjetër... ndonjë dashuri eventuale...

Natyrë e ëndrrave që shoh janë të ndryshme, por ka edhe që më frikësojnë. Shoh gjarpinj e krime... Shoh edhe zjarr dhe ëndrra të tjera që më frikësojnë. Të lutem, më ndihmo!

“Vera që shkoi”

Përgjigje:

Ëndrrat i referohen një sjelljeje të caktuar të vetëdijes. Nëse gjithnjë mendon keq, edhe ëndrrat do të jenë të kësaj natyre. Nëse ke forcë ta ruash kontinuitetin e shëndetshëm të të jetuarit, ti nuk do të biesh në grackën e ëndrrës së keqe.

Njeriu ka prirjen të mos pranojë të mposhtet as në ëndërr. Këtë e siguron ndërdija jonë që rri e zgjuar në mekanizmat e funksionimit organik.

Nëse njeriu ka vetëdije dhe karakter luftues në realitet, atëherë as në ëndërr nuk do të pranojë të pësojë disfatë. Ndërdija e ruan karakterin e njeriut...

Megjithatë, ka diçka më të madhe që duhet shpjeguar për të të ndihmuar. Ti je në kohën e menopauzës dhe mundimet që sjell kjo fazë janë të rënda. Duhet t'i bësh një varg testesh të natyrës gjinekologjike që lidhen me gjendjen hormonale dhe këtë më së miri duhet ta shpjegojë eksperti gjinekologjik. Ka shumë mundësi që ky problem të lidhet me këtë fazë që ke, pra me menopauzën. Mundësia tjetër është ta vizitosh psikiatrin. Ëndrrat që e godasin një të sëmurë klinik dhe një tjetër person që nuk ka probleme klinike shëndetësore, dallojnë në masë të madhe. Është e natyrshme se një i sëmurë që është i shtrirë, edhe në fazë kurimi mund të shohë ëndrra krejt të tjera nga njeriu që sheh ëndrra në fazën e gjumit në shtëpi. Pra, ti nuk je që vuan nga diçka, por mirë është të bësh teste të natyrës hormonale. U sugjeroj që për këtë problem të konsulto-

heni me ekspertin mjekësor dhe shpresoj se do ta tejkaloni gjendjen që e keni...

Nuk po mund ta dua burrin si dikur!

Zonjë e nderuar, jam 29-vjeçare, e martuar që dy vjet. Burrin e kam dashur shumë.

Ai ende më do dhe nuk ka hequr dorë për asnjë sekondë prej meje, duke më dashur si nga dita e parë, për çka më bën më së shumti obliguese ta dua edhe unë, por te unë nuk janë gjërat në rregull.

Tri herë jam larguar prej tij dhe jam ndarë me iniciativën time. Më vjen si me vrull një ide se unë aty nuk kam jetë dhe kërkoj ndarjen prej tij, e, pastaj, në shtëpi te babai më vjen ideja të kthehem se kam gabuar.

Tri herë më është përsëritur ky proces dhe tani më ka thënë burri se po dole edhe një herë më nuk do të bashkohemi. Mua më vjen akoma ai vrull, por po përmbahem. Në momentet e tillë po shtrihem në dhomën time, duke u bërë se jam e sëmurë.

Të lutem, më ndihmo!

A do të jetoj bashkë me burrin dhe a do të kem jetë të mirë?

A do të kem fëmijë dhe kur, sepse, ndoshta, fëmija do t'më qetësojnë në martesë?

“Dilema”

Përgjigje:

Ju keni magji në shtëpi dhe pa e larguar magjinë nuk do të rehatoheni. I ke tre fustane të prerë dhe një xhakëtë të bardhë, të cilën nuk e ke veshur që nga dita kur je bërë nuse.

Prerjet janë bërë për qëllime të tilla. Nga xhaketa është marrë një copëz e vogël, që ka shërbyer për

qëllime të liga.

Posa t'i largosh prej shtëpisë, do të ndryshojë gjendja jote shpirtërore dhe psikike dhe dashuria ndaj burrit do të rritet në përmasat e normales që keni pasur.

Ju e dini se magjitë janë reale dhe pasojat prej tyre janë evidente dhe në varësi kush për kënd dhe sa, ato godasin dhe krijojnë gjendje labile në mesin e bashkëshortëve.

Dora e gruas që mi prishi katër shtatzëni gjatë gjumit...

Jam një zonjë që ende nuk jam bërë nënë. Këtë ma ka pamundësuar një dorë gruaje gjatë gjumit, e cila më shtyp natën. Kam rënë gati edhe në depresion, sepse burri thotë që gjoja nuk e dua dhe nuk dua ta mbajë fëmijën e tij, ashtu që ai po dishon se unë vetë po e shkatërroj çdo shtatzëni...

Ai nuk po më beson se para gjashtë vjetësh, në muajin e tretë të shtatzënisë, derisa isha në gjumë, erdhi një grua me flokë të thinjura dhe më shtypi në gjoks shumë, pastaj edhe në bark, mu në vendin e foshnjës dhe pas një ore ndjeva dhimbje të forta, kështu që dështova. E, meqë ishte hera e parë, nuk e mora tragjike.

Pas tetë muajsh mbeta sërish shtatzënë dhe, pasi e kisha kaluar muajin e dytë të shtatzënisë, e njëjta grua erdhi gjatë natës dhe më shtypi aq shumë sa pothuajse menjëherë abortova. Kështu ndodhi edhe herën e tretë dhe të katërt.

Andaj, po mërzhitem, jo vetëm që nuk po mbes shtatzënë, por kam filluar t'i frikësohem figurës së asaj gruaje që po më vjen në ëndërr kur jam shtatzënë. Zonjë e nderuar, i kam shpre-

sat në ty. Kam qenë në disa vende të shenjta dhe, së fundi, më kanë thënë se vetëm ti mundesh t'më bësh zgjidhje... Si ta largoj këtë tmerr që po më merr fëmijët ende pa lindur?

“Dora e huaj”

Përgjigje:

Para së gjithash, ti nuk je e vetmja në atë shtëpi që ke pësuar nga ajo goditje e asaj dore të keqe që t'i merr fëmijët në barkun tënd.

Ju, me gjasë, e keni blerë atë shtëpi dhe nuk jeni aty pronari fillestar.

Pyeteni ish-të zotin e shtëpisë dhe do t'ua tregojë historinë e gruas së vet, e cila ka pasur disa dështime dhe vetëm kur ka qenë jashtë vendit, si azilante, ka mundur t'i ketë dy fëmijë, sipas parashikimit tim që më del për këtë rast.

Preferenca ime është të mos mbetesh më shtatzënë në atë shtëpi, sepse asnjë fëmijë nuk do ta lindësh aty, bile ka mundësi ta rrezikoni edhe shëndetin tuaj. Andaj, sapo të kaloni në një shtëpi tjetër, do të keni fëmijë.

A është njerëzimi në luftë me natyrën?

Jam profesoreshë e pensionuar, 67-vjeçare. Përcjelli dokumentarë shkencorë dhe ndryshimet në kozmos.

Dhe, gjithnjë e më shumë më duket se sot njerëzimi është në një lloj lufte me natyrën, për çka desha t'më përgjigjeni nëse kam të drejtë apo jo...

“B”

Përgjigje:

Në fakt, sot bota është në një luftë të vërtetë ndërnjerëzore, fundamenti i së cilës luftë qëndron tek religjionet.

Sot njerëzimi mund të bindet se sa shumë janë të fuqishme bazat fetare dhe ajo që thotë një filozof se “feja dhe populli janë fuqi të

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

papërmbytshme”!

Sot nuk ka nevojë për shpallje luftërash, e që dikur janë bërë si akte burrërore. Politikat moderne sot krijojnë grupe guerile dhe shkatërrojnë pa mëshirë njerëz e objekte të ndryshme.

Andaj, njerëzimi nuk ka qenë kurrë më i pasigurt se sot në tërë botën. E, njerëzimi sot, përveç dhunës ndërnjerëzore kërcënohet edhe nga natyra, sistemi i goditjes së trupave qiellorë dhe nga detet e oqeanet, të cilët shkaktojnë cuname që shkatërrojnë çdo gjë para vetes...

Çka po ndodhë me vajzën time?

Ju besoj shumë, sepse kam pasur një problem që ju ma zgjidhët...

Vajza ime është e martuar dhe e ka një fëmijë, i cili përngjanë shumë në magjup.

Vajza më thotë se më nuk e do burrin dhe më ka kërkuar falje për gabimin.

“Pa shifër”

Përgjigje:

Këshilla ime është: Këshillojeni vajzën të largohet prej tij, sepse ka për t'i krijuar vuajtje vetes.

Mos përdorni dhunë kundër saj, sepse dhuna e shtynë kah ai person. Këshillojeni dhe hapjani rrugën për në fakultet dhe aty do ta gjejë rehabilitimin e plotë dhe fatin e jetës që i përshtatet asaj dhe juve. Harroni hulumtimet kush, si e çka, sepse sa më shumë që hulumtoni, aq më shumë e bëni aktual problemin.

Si jetoi 23 vjet vajza nga Mitrovica me copëz granate nën gjuhë?

Për 23 vjet vajza nga Mitrovica nuk e kishte vërejtur se në trupin e saj po qëndronte një copëz granate. Dyshimet u shfaqën atëherë kur te ajo nisën dhembjet e mëdha dhe problemet në të folur.

Dhe, pas 23 vjetësh plaga e luftës u mënjanua vetëm pak javë më parë, pas një operacioni në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

Copëza mbi dy centimetra u bë pjesë e trupit të saj kur ajo, gjatë luftës, bashkë me familje u përbal-

lën me granatime të forcave serbe.

Rasti kishte ndodhur në fshatin Vaganicë të Mitrovicës, ku mbetën të vdekur disa persona, përfshirë familjarë të afërt të 38-vjeçares. Dhe, shkaku i kohës së gjatë plaga nisi t'i shkaktojë probleme. "Pacientja ishte në një gjendje të rëndë shëndetësore, me dhimbje të mëdha, me pamundësi për t'u ushqyer si duhet, shkaku se çdo lëvizje e gjuhës ka shkaktuar dhimbje të mëdha në regjionin nëngjuhorr", ka thënë Milot Ademaj, mjek.



Pjesa e granatës që i është nxjerrë pacientes

Ndodh edhe kjo...

Në taksi me të dashurin, shofer ishte burri i saj!



Shoferi i një taksi mori një telefonatë nga një njeri që donte ta çonte në destinacionin e dëshiruar, bashkë me një femër me të cilën argëtohej. Dhe, femra, teksa hipi shpejt në automjet me të dashurin e saj, nuk i kushtoi vëmendje faktit se burri i saj ishte shoferi i taksisë. E, shoferi, kur i çoi në vendin e dëshiruar, hoqi syzet dhe maskën nga goja dhe u kthye kah gruaja e tij.

Ajo, kur pa se çka kishte bërë, nxori unazën nga gishti dhe ia ktheu burrit.



ASSBAU





SHERWOOD

Resorts and Hotels



SHERWOOD
exclusive Kemer

SHERWOOD
exclusive Lara

SHERWOOD
Dreams Resort

3UE
TUI BLUE
Belek

SHERWOOD
Suites Resort

SHERWOOD
Greenwood Resort

SHERWOOD
Premio Hotel

www.sherwoodhotels.com.tr

[sherwoodresorts](https://www.instagram.com/sherwoodresorts)